





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA KUSHTETUESE

Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese

Vendimet shtator-tetor 2024



Buletini periodik i vendimmarrjes
Nr. 5 , shtator-tetor 2024
© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë



Ky botim u mundësua me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Shënim: Opinonet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë botim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



HYRJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës shtator-tetor 2024.

PËRMBAJTJA

Ankim kushtetues individual
(vendime përfundimtare)

..... 4

E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Afat i arsyeshëm/ shkelje e afatit të arsyeshëm/ tejzgjatjes e paarsyeshme e afatit/ çështje me objekt të drejta të fëmijës apo me ndikim të fëmija i mitur

Gjykata çmon se çështja e kërkuases, me objekt të drejtat e fëmijës apo që kishin ndikim te një fëmijë, paraqiste përparësi në shqyrtim në drejtim të interesit që i cenohej kërkuases si rrjedhojë e tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Alida Gazidedja (cenimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së gjykimit në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë) - Vendim nr. 58 datë 17.09.2024

Faktet

Kërkuësja dhe shtetasi Leonard Toçi kanë lidhur martesë në vitin 2000 dhe 5 vjet më pas ju lindi fëmija, Brooklyn Toçi. Në 2010 Leonard Toçi iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e martesës, si dhe të pasojave të saj. Gjykata e Tiranës vendosi pranimin e padisë, zgjidhjen e martesës dhe të pasojave në lidhje me fëmijën. Kërkuësja ushtroi ankim, duke pretenduar, ndër të tjera, se me vendim të gjykatës së Bolzanos, Itali, është vendosur zgjidhja e martesës, por pasojat ishin zgjidhur ndryshe, vendim ky që kishte marrë formë të prerë para se sa të vendoste gjykata e Tiranës. Gjykata e Apelit Tiranë e la në fuqi vendimin e gjykatës së Tiranës për sa i përket zgjidhjes së martesës, si dhe prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim për sa i përket rregullimit të pasojave për fëmijën. Mbi rekursin e kërkuases, Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykata e apelit nuk kishte marrë në konsideratë ekzistencën e vendimit civil të gjykatës italiane. Në rigjykim, gjykata e apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Tiranës. Kërkuësja ushtroi rekurs në 16.11.2016. Meqenëse rekursi nuk po shqyrtohej, në datat 02.09.2020 dhe 18.09.2020, kërkuësja i është drejtuar dy herë po Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit. Me vendimin nr. 9/5, datë 26.07.2023, Gjykata e Lartë vendosi pushimin e gjykimit të çështjes lidhur me shkeljen e afatit, për shkak se një Kolegj tjetër i saj që kishte në shqyrtim çështjen në themel, kishte caktuar datën 20.09.2023 për shqyrtimin e çështjes, Kolegj i cili vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në gjykatë. Kërkuësja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*).

Vlerësimi i Gjykatës

Për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm - Kërkuësja ka pretenduar se rekursi i saj është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë pas rreth 6 vjetësh e 8 muajsh, ndërsa kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit pas rreth 2 vjetësh e 10 muajsh.

Për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, Gjykata analizon rrethanat e veçanta të çështjes konkrete në lidhje me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuases; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuësja. Në lidhje me sjelljen e kërkuases Gjykata vlerëson se kërkuësja ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe nuk rezultoi të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes. Për sa i takon kompleksitetin të çështjes palë në proces kanë qenë vetëm kërkuësja dhe ish-bashkëshorti i saj dhe çështja nuk rezultoi të ketë qenë komplekse ose të ketë pasur volum të lartë aktesh provuese, çka mund të ndikonte në kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit.

Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata vlerëson se sjellja e autoriteteve nuk ka qenë në nivelin e duhur për sa i përket eficiencës së gjykimit. Së fundmi, në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuësja, në këndvështrim të përcaktimeve të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si çështje që kishte për objekt të drejta të fëmijës apo që kishin ndikim te një fëmijë i mitur kishin përparësi në gjykim, Gjykata çmon se çështja e kërkuases paraqiste përparësi në shqyrtim në drejtim të interesit që i cenohej kërkuases si rrjedhojë e tejzgjatjes së gjykimit. Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, pasi shqyrtimi prej saj i çështjes ka tejkaluar kufirin kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues.

Duke qenë se vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet për shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizën e pretendimeve të tjera të kërkuases.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

**Proces i rregullt ligjor—
E drejta për gjykim
brenda një afati të
arsyeshëm**

FJALË KYÇE

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së/ afat i arsyeshëm/ kritere të jurisprudencës kushtetuese/ kohëzgjatje e pajustifikuar e shqyrtimit gjyqësor/ pamundësi objektive/ ngarkesa e lartë në gjykatën e apelit/ reforma në drejtësi/

Kërkuesi nuk ka arritur të parashtojë shkaqe të mjaftueshme për të provuar se çështja e tij është e një natyre të tillë që të rrezikojë interesin e tij në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore.

Arben Malaj (cenimi i të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së gjykimit në gjykatën e apelit) – Vendim nr. 59 datë 17.09.2024

Faktet

Kërkuesi kryente detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së nga dhjetori 2018 deri në dhjetor 2019. Me vendim të Kuvendit, kërkuesi u shkarkua nga kjo detyrë. Kërkuesi paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit. Gjykata e Tiranës vendosi rrëzimin e saj si të pambështetur në ligj. Kërkuesi u ankua dhe çështja u regjistrua në Gjykatën Administrative të Apelit në 18.11.2020. Meqënëse çështja nuk po gjykohej, në 31.08.2023 kërkuesi paraqiti kërkesë në gjykatën e apelit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përsheptimin e procedurave gjyqësore. Kjo kërkesë iu përcoll Gjykatës së Lartë, dhe u regjistrua atje më 10.10.2023. Për vonesën, Gjykata e Lartë i kërkoi mendim gjykatës së apelit, e cila i dërgoi informacionin e gjyqtarit relator për çështjen. Sipas gjyqtarit relator, ngarkesa e tij deri në atë moment ishte 2754 çështje, dhe se kërkesa për shkelje të afatit të arsyeshëm ishte paraqitur nga kërkuesi pa u plotësuar afati 30-ditor i gjykimit në gjykatën e apelit (nga momenti që çështja iu shortua këtij gjyqtari). Në vijim Gjykata e Lartë, vendosi mospranimin e kërkesës së kërkuesit, pasi shkelja e afatit të arsyeshëm në gjykatën e apelit ishte pasojë e volumit të madh të çështjeve të mbetura pa gjykuar, gjë që përbënte një pamundësi objektive për procedim. Më 22.02.2024 kërkuesi iu drejtuar Gjykatës.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Në lidhje me këtë, Gjykata analizon rrethanat e veçanta të çështjes konkrete në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që kërkuesi ose palët në proces të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes. Edhe për sa i takon kompleksitetit të çështjes, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, dhe se, ashtu si edhe vetë Gjykata e Lartë e ka çmuar, çështja nuk paraqitet komplekse për të justifikuar kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është në pritje për shqyrtim në gjykatën e apelit prej pothuajse 4 vjetësh, ndërkohë që aktualisht në këtë gjykatë janë në radhë për gjykim çështjet e regjistruara në vitin 2017, si dhe çështjet me përsheptim shqyrtimi me kërkesë të palëve sipas vendimit 78/2019 të KLGJ-së. Bazuar në treguesit e mësipërm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuesit lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Së fundi, në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata konstaton se detyra si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, nuk e pengon këtë anëtar të kryejë njëkohësisht edhe detyra të tjera. Kjo nënkupton se aktiviteti si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jetë i vetmi funksion që ai mund të ushtrojë e, për pasojë, edhe shpërblimi prej kësaj detyre nuk është i vetmi burim jetese për të. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të parashtojë shkaqe të mjaftueshme për të provuar se çështja e tij është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës. (një gjyqtar u shpreh me mendim pakice kundër)

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Minator/ Pension i parakohshëm/ pensionist/ afati i arsyeshëm/ mjet i domosdoshëm jetese/ reforma në drejtësi/ ngarkesë e sistemit gjyqësor/

Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm. Të tilla janë edhe mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtën e pensionit, të cilat duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces.

Haki Kosta (cënimi i procesit të rregullt ligjor lidhur me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm në gjykatën e apelit) – vendimi nr. 60, datë 19.9.2024

Faktet

Kërkuesi ka qënë minator në disa miniera. Si i tillë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH) e shpalli kërkuesin përfitues të pensionit të parakohshëm “trajtim i veçantë minatori”, bazuar në ligjin 8685/2000. Pasi u miratua ligji 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, kërkuesi paraqiti një kërkesë pranë DRSSH-së për përfitimin e pensionit të pleqërisë. DRSSH-ja vlerësoi se kërkuesi nuk plotësonte kushtet e parashikuara në ligjin 8685/2000 dhe vendosi mbylljen e pensionit të caktuar dhe refuzimin e kërkesës për përfitim pensioni sipas ligjit nr. 150/2014, si dhe e shpalli kërkuesin debitor për një shumë lekësh. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila vendosi pranimin e padisë dhe anulimin e akteve administrative të DRSSH-së, e cila e ankoj vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit, dhe çështja u regjistruar në këtë gjykatë më 4.6.2018. Në kushtet kur gjykata e apelit nuk ndërmoi asnjë veprim deri më 2.12.2022, kërkuesi iu drejtua gjyqtarit relator, për të kërkuar përshpejtimin e gjykimit. Në mungesë të një përgjigjeje, kërkuesi më 16.2.2023, iu drejtua Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Gjykata e Lartë vendosi rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive dhe se nuk ka zvarritje të qëllimshme nga gjyqtari relator. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Cënimi i të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Gjykata vërejt se mosmarrëveshja lidhej me një mjet të domosdoshëm të jetesës, siç është e drejta e pensionit. Ndonëse kanë kaluar mbi 5 vjet ende nuk ka një vendimmarrje në lidhje me themelin e saj, që do të thotë se gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit është tejzgjatur. Në këtë kontekst, Gjykata analizoi rrethanat e veçanta të çështjes në kuadrin e kriterëve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

Së pari, Gjykata konstatoi se kërkuesi kishte kryer të gjitha veprimet që tregonin se vonesa nuk erdhi prej sjelljes së tij. Së dyti, Gjykata vlerësoi se çështja e kërkuesit nuk paraqitej komplekse, në atë masë që të justifikonte kohëzgjatjen e shqyrtimit për më shumë se 5 vjetë. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, Gjykata, ndonëse mbajti parasysh situatën faktike aktuale të ngarkesës së madhe të sistemit gjyqësor, për sa i përket rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata vërejt se rrethanat e kërkuesit janë të veçanta (minator i nëntokës dhe aktualisht 67 vjeç). Çështja e tij lidhet me një mjet të domosdoshëm të jetesës, siç është e drejta e pensionit si ish-minator i nëntokës. Sipas KLGJ-së, çështjet e përfitimit të pensionit janë të një natyre specifike dhe duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi njëzëri pranimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën pjesërisht me mendim kundër).

**Proces i rregullt ligjor—
Standardi i arsytimit të
vendimit gjyqësor –
parimi i prezumimit të
pafajësisë**

FJALË KYÇE

***Sigurime shoqërore/ Dublim/
Mashtrime në sigurime /
Falsifikim/ Ripërcaktim
faktesh/ Përtej çdo dyshimi të
arsyeshëm/ Prezumimi i
pafajësisë / standardi i
arsytimit***

**Prezumimi i pafajësisë
nënkupton që gjykatat e
zakonshme nuk duhet ta
fillojnë procesin me
bindjen se i pandehuri ka
kryer krimin për të cilin
akuzohet, se barra e
provës i takon palës
akuzuese, se çdo dyshim
duhet të shkojë në favor të
të pandehurit dhe se
gjykata duhet ta mbështesë
vendimin në prova të
drejtpërdrejta dhe të
tërthorta që duhet të
provohen nga akuza.**

Prend Suta (cenimi i standardit të arsytimit të vendimit për shkak se vepra penale nuk ishte provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm) – vendimi nr. 61, datë 19.9.2024

Faktet

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër (“DRSSH”) bëri kallëzim penal ndaj kërkuesit për veprën penale “mashtrimi në sigurime”, për shkak se ishin evidentuar dublim të periudhave të punësimit të kërkuesit në regjistrin themeltar të punonjësve në dy ndërmarrje të ndryshme. Duke e konsideruar veprën penale të provuar, prokuroria ia kaloi dosjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, e cila vendosi deklarinin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes, për arsye se organi i akuzës nuk provoi, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se kërkuesi kishte kryer veprën penale. Prokuroria bëri rekurs dhe Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Pukës. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar ndër të tjera, mungesën e arsytimit në lidhje me provimin e fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit.

Vlerësimi i Gjykatës

Në vlerësimin e Gjykatës, në kushtet kur aktet zyrtare kanë sjellë të dhëna të ndryshme për të njëjtin fakt, Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar përgjegjësinë ligjore të kërkuesit përmes arsytimit të rrethanave faktike të rëndësishme për çështjen. Konkretisht, Gjykata analizoi arsytimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me përgjegjësinë ligjore të kërkuesit, bazuar në analizën e përfundimeve të dy akteve të ekspertimit. Sipas Gjykatës së Lartë, në regjistrin e njërës prej ndërmarrjeve ka korrigjime të ditës së fillimit të marrëdhënies së punës dhe askush tjetër nuk ka pasur interes për të pasqyruar këtë periudhë pune në regjistër [*përveçse kërkuesit!*], prandaj ai rezultoi të ketë paraqitur rrethana të rreme pranë organeve të sigurimeve shoqërore, me qëllim përfitimin e padrejtë të pensionit. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së Pukës, pavarësisht se në vendimin e saj nuk është arsytuar lidhur me elementet e veprës penale, nuk është argumentuar se nga kush është falsifikuar fleta e regjistrit të punësimit dhe se si është arritur në këtë përfundim në lidhje me një dokument që është administruar nga vetë DRSSH-ja. Gjykata e Lartë i analizoi edhe një herë provat e marra në shqyrtim nga gjykatat e faktit, duke i plotësuar ato, rrjedhimisht ajo ripërcaktoi faktet e çështjes, duke bërë vlerësim të mëtejshëm të provave nga ai i gjykatave të faktit. Gjykata vlerësoi se mënyra se si ka vepruar Gjykata e Lartë në raport me pasojat e ardhura për kërkuesin (deklarimin e tij fajtor), konkretisht duke mos arsytuar pse nuk duhet të merren në konsideratë rrethanat dhe provat që ishin në favor të kërkuesit, as pse dyshimet për akuzën nuk janë çmuar në favor të tij dhe duke ripërcaktuar faktet e çështjes në kufijtë e hamendësimeve, vuri në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të garantimit të prezumimit të pafajësisë dhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi njëzëri pranimin e kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor—E drejta aksesit në gjykatë

FJALË KYÇE

Rekurs/ Mbrojtës i palegjitimuar/ Njoftim i kthye me shënimin “larguar”/ plotësim i të metave formale/ konfirmim vullneti/ legjitimim mbrojtësi/ qëndrim formalist/ proces i rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme/

Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formalist, pasi veprimet e kryera prej saj nuk i kanë shërbyer saktësisht të të metave të rekursit.

Gjykata e Lartë i ka të gjitha hapësirat që, në përputhje me funksionin e saj interpretues, t'i interpretojë kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi dhe plotësimin e të metave të tij për të garantuar të drejtat themelore, përfshi edhe të drejtën të aksesit në gjykatë.

Ardian Narkaj (cënimi i procesit të rregullt ligjor për shkak të mos garantimit të të drejtës për akses në gjykatë) - vendimi nr. 63 datë 24.09.2024

Faktet

Në fshatin Bratosh të Malësisë së Madhe, dy shtetas janë vrarë me armë zjarri, ndërsa kërkuesi është plagosur. Të nesërmen, kërkuesi është ndaluar si i dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe më pas ndaj tij është vlefshuar masa e sigurimit “arrest në burg” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në përfundim të hetimeve, prokurori e ka dërguar çështjen për gjykim duke e akuzuar kërkuesin për veprat penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake. Gjykata e Shkodrës e deklaroi fajtor kërkuesin për të dyja akuzat. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër e prishi vendimin dhe e ktheu çështjen për rigjykim. Më pas çështja është rigjykuar disa herë në shkallë të parë, në gjykatën e apelit dhe në Gjykatë të Lartë. Ndërkohë që çështja pritej të merrej në shqyrtim për herë të fundit në Gjykatë të Lartë, kërkuesi është arrestuar në ekzekutim të vendimit penal në ngarkim të tij dhe u dërgua në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të fundit me arsyetimin se rekursi i kërkuesit ishte nënshkruar dhe depozituar nga një mbrojtës i palegjitimuar. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është shqyrtuar në një proces gjyqësor që ka zgjatur rreth 15 vjet. Përgjatë këtij procesi, kërkuesi është përfaqësuar nga 6 mbrojtës të ndryshëm. Rekursi i fundit në Gjykatën e Lartë, është përpiluar në emër të kërkuesit, ndërsa është nënshkruar në çdo faqe nga mbrojtësi i parë, ku gjendet edhe një shënim i kërkuesit me shkrim dore.

Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, krahas shqyrtimit të rekursit të kërkuesit, ka filluar procedurën e plotësimit të të metave formale të tij, duke kryer veprime specifike për të konfirmuar vullnetin e kërkuesit në drejtim të paraqitjes së rekursit dhe zgjedhjes së mbrojtësit të parë që kishte nënshkruar rekursin. Mirëpo, gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kërkuesi ka qenë i izoluar, duke vuajtur dënimin penal në ngarkim të tij, ndaj akti i njoftimit i dërguar në banesën e tij dhe i kthyer me shënimin “larguar” qartësisht nuk i ka shërbyer qëllimit që Gjykata e Lartë ka pasur për të garantuar vullnetin e kërkuesit lidhur me paraqitjen e rekursit dhe legjitimitimin e mbrojtësit të tij të parë.

Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formalist, pasi veprimet e kryera prej saj nuk i kanë shërbyer saktësisht të të metave të rekursit në drejtim të verifikimit të vullnetit të kërkuesit. Gjykata e Lartë i ka të gjitha hapësirat që, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës, kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi dhe plotësimin e të metave të tij t'i interpretojë me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit në gjykatë. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.

Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me cenimin e parimeve të barazisë së armëve dhe të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata rithekson se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Për sa kohë çështja e kërkuesit do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, kjo e fundit duhet t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs nga kërkuesi dhe të respektojë ajo vetë standardet e procesit të rregullt, ndaj Gjykata çmon të mos shprehet për to.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesëshëm të kërkesës

E drejta për proces të rregullt ligjor—E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme—Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor—E drejta e aksesit për vendim gjyqësor

FJALË KYÇE

Prokuror/ ngritje në detyrë/ rekurs i veçantë/ rekurs i paraqitur jashtë afati ligjor/ përjashtimi i gjyqtarit/ testi objektiv dhe testi subjektiv/ çështje të ndryshme juridike/ kufizimi i të drejtës së aksesit

Respektimi i parimi për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme (një gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë në dy çështje më të njëjtat palë), duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv dhe testin objektiv. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses lidhet me testin objektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës. Gjykata e Lartë, edhe pse formalisht ka pasur për shqyrtim të njëjtin proces gjyqësor me të njëjtat palë ndërgjyqëse, në thelb ka shqyrtuar çështje të ndryshme juridike.

E drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike.

Ndonëse aksesi i kërkueses është kufizuar nga vendimi i mospranimit të rekursit, kufizimi është në përputhje me Kushtetutën, për sa kohë rekursi është paraqitur prej saj përtej afatit ligjor.

Sonila Muhametaj (cënimi i të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, për shkak të pjesëmarrjs së një gjyqtari në dy çështje që pretendohen të lidhura; cënimi i të drejtës së aksesit për shkak se rekursi u konsiderua jashtë afatit) - Vendim nr. 64 datë 01.10.2024

Faktet

KLP-ja filloi procedura për ngritjen në detyrë nga radhët e prokurorëve për dy pozicione të lira në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Tre prokurorë, përfshi kërkuesen, kandiduan për këto vende. Në lidhje me këtë, KLP-ja nxorri 5 vendime, sipas të cilëve kërkuësja u rendit e treta, dhe dy kandidatët që zunë vendet e para, u emëruan në Prokurorinë e Posaçme. Kërkuësja u ankuu në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila vendosi pranimin e pjeshëm të padisë së kërkueses, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të të gjithë vendimeve të KLP-së. Avokatura e Shtetit paraqiti rekurs të veçantë, që u pranua nga gjykata e apelit. Kërkuësja paraqiti kundërrekurs. Gjykata e Lartë e shqyrtoi çështjen në dhomën e këshillimit dhe vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, dhe e dërgoi çështjen për rigjykim po atje. Pa u bërë gjykimi në gjykatën e apelit, kërkuësja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), Kolegji i së cilës vendosi moskalimin e çështjes në seancë plenare me arsytimin se kërkuësja nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive. Në rigjykim, gjykata e apelit e rrëzoi padinë e kërkueses. Kërkuësja paraqiti rekurs, të cilin gjykata e apelit e rrëzoi se rekursi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor. Më tej, kërkuësja paraqiti rekurs të veçantë të dytë, të cilin gjykata e apelit ia dërgoi Gjykatës së Lartë. Kur erdhi ne dijeni të trupit gjykues, kërkuësja paraqiti kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit relator, me argumentin se ai kishte qenë pjesë e trupit gjykues në dhënien e vendimit të mëparshëm në Gjykatë të Lartë. Kjo kërkesë nuk u pranua. Gjykata e Lartë vendosi gjithashtu edhe rrëzimin e rekursit të kërkueses, e cila më pas iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Në drejtim të legjitimitimit racione materiae. Kërkuësja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar për shkak se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, edhe pse çështja ishte komplekse. Gjykata çmon se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se si gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit ka ndikuar në këtë të drejtë kushtetuese. Vetëm argumenti se çështja duhej të ishte shqyrtuar në seancë publike për shkak të kompleksitetit, nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt.

Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Në këtë aspekt, kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit i ka cenuar asaj të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi një prej gjyqtarëve ishte pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që kishte vendosur më parë prishjen e vendimit të gjykatës së apelit në favor të kërkueses. Gjykata ka pohuar se respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv dhe testin objektiv. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses lidhet me testin objektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuësja, Gjykata e Lartë, edhe pse formalisht ka pasur për shqyrtim të njëjtin proces gjyqësor me të njëjtat palë ndërgjyqëse, në thelb ka shqyrtuar çështje të ndryshme juridike. Në këtë mënyrë, pretendimi i kërkueses se gjyqtari i Gjykatës së Lartë që ka dhënë dy vendime në çështjen e saj ka pasur paragjykim të papajteshme me parimin e paanshmërisë, nuk qëndron. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në drejtim të testit objektiv.

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Kërkuësja ka pretenduar se vlerësimi i gjykatave se rekursi i saj ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, çka i ka cenuar asaj të drejtat kushtetuese. Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'u drejtuar gjykatës. Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Kështu, ndonëse aksesi i kërkueses është kufizuar nga vendimi i mospranimit të rekursit, kufizimi është në përputhje me Kushtetutën, për sa kohë rekursi është paraqitur prej saj përtej afatit ligjor. Po kështu, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë, ndryshe nga sa pretendon kërkuësja, paraqitet i rregullt në formë dhe në përmbajtje, dhe në pjesën arsytuese u jep përgjigje pretendimeve të saj të parashtruara në rekursin e veçantë. Në kushtet kur nga gjykimi kushtetues i çështjes rezultoi se procesi gjyqësor për mospranimin e rekursit të kërkueses ka qenë në përputhje me Kushtetutën, atëherë ajo e ka humbur mundësinë për t'i ngritur pretendimet në ankimin kushtetues individual për sa kohë nuk janë shteruar mjetet juridike që kërkuësja ka pasur në dispozicion.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

**Procesi i rregullt ligjor—
E drejta për gjykim
brenda një afati të
arsyeshëm**

FJALË KYÇE

**Student/ Zgjedhjet e Senatit
Akademik/ afati i arsyeshëm/
kriteret të jurisprudencës
kushtetuese/ tejzgjatje e
gjyqimit/ pamundësi
objektive/ reforma në drejtësi/
ngarkesë e lartë në gjykatën e
apelit**

**E drejta që kërkohet të
mbrohet është një e drejtë,
që sipas ligjit, mund të
realizohet vetëm brenda një
afati të caktuar kohor. Për
sa kohë që realizimi i së
drejtës lidhet me një afat të
caktuar kohor, ky afat
përcakton edhe vetë thelbin
e të drejtës, mosrealizimi i
së cilës gjatë këtij afati e bën
vetë të drejtën iluzore.**

Agred Tafaj (cenimi i të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së kohës në pritje për gjykim në gjykatën e apelit) – vendimi nr. 65, datë 2.10.2024

Faktet

Kërkuesi është regjistruar si kandidat nga radhët e studentëve për zgjedhjet e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës. Në përfundim të zgjedhjeve, Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) nxori vendimin përkatës, ku kërkuesi nuk rezultoi fitues. Vendimi i KIZ u la në fuqi nga Komisioni i Apelit (KA). Kërkuesi paraqiti padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilën kërkoi deklarimin e pavlefshëm të vendimeve të KIZ dhe KA, e cila e pranoi pjesërisht atë. Palët kundërshtarë paraqitën ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, ankim që u regjistrua më 28.4.2021. Kërkuesi paraqiti një kërkesë për përsheptimin e gjyqimit më datë 3.2.2022, por gjykata e apelit nuk ktheu përgjigje. Më 18.9.2023 kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjyqimit. Gjykata e Lartë vendosi rrëzimin e kërkesës. Sipas Gjykatës së Lartë, mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator. Po ashtu, Gjykata e Lartë vlerësoi se në rastet kur gjykata e apelit është në kushtet e pamundësisë objektive për shkak të ngarkesës së madhe. Në datën 13.3.2024 kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Cenimi i procesi i rregullt lidhur me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. - Gjykata analizoi rrethanat e veçanta të çështjes konkrete në raport me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese: (i) sjellja e kërkuesit; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi. Në lidhje me sjelljen e kërkuesit, Gjykata konstatoi se kërkuesi i është drejtuar si gjykatës së apelit, ashtu dhe Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk rezultoi që të jetë bërë shkak për tejzgjatjen e gjyqimit të çështjes së tij në gjykatën e apelit. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative dhe ka për objekt deklarimin pjesërisht të pavlefshme të akteve administrative për vlerësimin dhe renditjen e dy prej kandidatëve për Senatën Akademik. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se çështja konkrete nuk paraqitej komplekse. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, Gjykata konstatoi se çështja është ende në pritje për t'u shqyrtuar në gjykatën e apelit prej 3 vjet e gjysëm, dhe kohëzgjatja totale e procedurave është rreth 4 vjet. Ajo konstatoi gjithashtu se aktualisht në atë gjykatë janë në radhë për gjykim çështjet e regjistruara në vitin 2018 dhe ato me përsheptim gjyqimi mbi kërkesën e palëve. Si rrjedhim, tejzgjatja e afatit të gjyqimit të çështjes lidhet me ngarkesën e lartë të gjykatës së apelit. Për sa i përket asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata vlerësoi se në ankimin kushtetues është pretenduar se anëtarësia në Senatën Akademik ka një afat 4 vjeçar dhe se kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga dhënia e vendimit të gjykatës së Tiranës për regjistrimin e kërkuesit si anëtar i Senatit. Në këto kushte, shqyrtimi me vonesë i çështjes pamundëson ushtrimin e të drejtës për ta ushtruar atë mandat, duke e bërë vendimin përfundimtar joefektiv. E drejta që kërkohet të mbrohet është një e drejtë e parashikuar nga ligji dhe se mund të realizohet vetëm brenda një afati të caktuar kohor (mandat 4 vjeçar). Pra, për sa kohë që realizimi i së drejtës lidhet me një afat të caktuar kohor, ky afat është përcaktues i vetë kësaj të drejte. Për këto arsye, Gjykata evidentoi se koha e gjyqimit të çështjes së kërkuesit ka qenë thelbësore në drejtim të njohjes dhe eventualisht të ushtrimit të së drejtës. Tejzgjatja e gjyqimit ka bërë që e drejta e pretenduar, edhe nëse njihet gjyqësisht, të mbetet pa vlerë.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor — Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Aksident rrugor / shoqëri sigurimi / sigurim dëmi/ dëmshpërblim / afat dy dhe tre vjeçar parashkrimi/ parashkrim i padisë dhe vendim penal i formës së prerë/ parashkrimi i afatit dhe identifikimi i personit fajtor/

Interpretimi i ligjit i palidhur me faktet konkrete nuk pajtohet me gjykimin konkret, pasi, në thelb, nuk i shërben zgjidhjes së mosmarrëveshjes në fjalë. Kjo passjell, si pasojë, që pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë të jetë formalist dhe jokohërente në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese të individit.

Ndrec Lasku, Marte Lasku, Adelina Lasku, Gentjana Lasku, Mirela Ndoci (cenimi i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor për shkak të identifikimit të gabuar të personit ndaj të cilit duhej të paraqitej padia për shpërblimin e dëmit) – vendimi nr. 66, datë 3.10.2024

Faktet

Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerës Violeta Lasku, e cila ka humbur jetën në një aksident rrugor, në datën 29.5.2006. Prokuroria e Tiranës e pushoi procedimin penal dy herë. Mbi ankimin e kërkuesve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë urdhëroi vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve. Prokuroria u ankuu në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Tiranës. Në vijim, prokuroria mori si të pandehur drejtuesin e automjetit, duke e akuzuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, dhe, në përfundim të hetimeve, e dërgoi çështjen në gjykatën e Tiranës, e cila vendosi deklarimin fajtor dhe dënimin e drejtuesit të automjetit. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit. Pas përfundimit të procesit penal, kërkuesit iu drejtuan shoqërisë së sigurimit me kërkesë për dëmshpërblim. Në mungesë të përgjigjes, më datë 26.12.2013 ata iu drejtuan gjykatës me padi kundër shoqërisë së sigurimit për shpërblimin e dëmit. Gjykata e Tiranës vendosi rrezimin e padisë me arsytimin se padia ishte parashkruar, pasi ishte paraqitur jashtë afateve ligjore dy dhe trevjeçare. Me ankimin e kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së Tiranës, me arsytimin se padia nuk ishte parashkruar, pasi ajo ishte paraqitur brenda afateve ligjore, në kushtet kur afatet kanë filluar të ecin, pasi autori i ngjarjes u deklarua fajtor dhe u dënua me vendim të formës së prerë. Gjykata e Lartë vendosi, në dhomë këshillimi, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës Tiranë, me arsytimin se padia ishte e parashkruar. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor - Gjykata konstatoi se Gjykata e Lartë, megjithëse ende nuk kishte një vlerësim përfundimtar për themelin, çmoi ta zgjidhë vetë mosmarrëveshjen, duke konsideruar se çështja ka lidhje me interpretimin e ligjit rreth afateve të parashkrimit të padisë. Ajo analizoi dispozitat e KC-së që rregullojnë parashkrimin e padisë, sipas të cilave parashkruhen brenda dy vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit sipas kontratës së sigurimit dhe brenda tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor. Sipas Gjykatës së Lartë, padia u paraqit rreth shtatë vjet pasi kishte ndodhur aksidenti, pra përtej afatit ligjor. Gjykata konstatoi se ndërsa Gjykata e Lartë kishte trajtuar institutin e parashkrimit të padisë, ajo nuk kishte analizuar dhe as nuk ishte shprehur rreth faktit se nga data kur ndodhi aksidenti (29.5.2006) deri në datën kur kërkuesit ngritën padi (26.12.2013), ishte zhvilluar një proces penal, i zgjatuar në kohë dhe dinamik në veprime procedurale. Gjykata çmoi se Gjykata e Lartë nuk e kishte interpretuar ligjin e zbatueshëm në koherencë me rrethanat e faktit, pasi megjithëse kishte parashtruar se prokuroria e ka pushuar dy herë çështjen për shkak se nuk provohej që drejtuesi i automjetit të kishte shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, ajo kishte arritur në përfundimin se afati i parashkrimit të padisë civile për shpërblimin e dëmit fillonte nga dita e aksidentit. Për pasojë, ajo nuk argumentoi se ndaj kujt mund të paraqitej padia për shpërblimin e dëmit në periudhën gjatë së cilës prokuroria dhe gjykata ende nuk kishin identifikuar personin përgjegjës – shkakhtar i dëmit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor — E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme — Standardi i arsytimit të vendimit — Parimi barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

FJALË KYÇE

Proces privatizimi/ Kallëzim (për punim të ri)/ mosformim kuorumi/ rihapje e procesit gjyqësor/ përjashtim gjyqtari / arsytim de plano i vendimi/ thirrje e personit të tretë dhe e ekspertit/

Kërkuesja kishte pranuar se nuk kishte paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve, madje në procesverbalin e seancës përkatëse, rezultonte se palët, përfshi kërkuesen, ishin shprehur dakord me trupin gjyqësor. Rrjedhimisht, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike.

Ndonëse Gjykata e Lartë arsyeton në mënyrë të kufizuar de plano, [ajo] në mënyrë të nënkuptuar tregon se kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë nga çështjet e ligjit të parashikuara në dispozitat ligjore. Gjithashtu edhe kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje për faktin se arsytet ligjore nuk janë të mbështetura, arsytimi i kufizuar mund të plotësojë kriteret ligjore dhe ato të nenit 6 të KEDNJ-së.

Shoqëria “Prodhim Veshje nr. 2” sh.a. (cenimi i të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për shkak të mungesës së paanshmërisë së gjyqtarëve në gjykatën e apelit dhe mungesës së arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë) – vendimi nr. 67, datë 3.10.2024

Faktet

Kërkuesja ka në pronësi ndërtesa dhe truall, pjesë të ish-Ndërmarrjes së Prodhim Veshjeve (ish-NPV), të privatizuara në kohë të ndryshme. Gjatë procesit të privatizimit njëra prej ndërtesave nuk u përfshi në kapitalin e ish-NPV-së. Kjo ndërtesë që nuk u përfshi iu shit një pale të tretë e cila, në vitin 1997 ia dhuroi njërit prej subjekteve të interesuara, i cili filloi dhe ndërtimi i një godine mbi të. Kërkuesja paraqiti padi me objekt kallëzimin e punimit të ri, me pretendimin se trualli ku po bëhej ndërtimi nuk i ishte shitur subjektit të interesuar. Kërkuesja paraqiti gjithashtu dhe kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë, e cila u pranua nga të tre gjykatat. Për gjykimin e themelit të padisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vitin 2008 vendosi rrëzimin e padisë dhe të masës së sigurimit të padisë, vendim që është lënë në fuqi si nga Gjykata e Apelit, ashtu dhe nga Gjykata e Lartë. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata). Me vendimin 44/2013 Gjykata vendosi refuzimin e kërkesës, për shkak se nuk arriti kuorumin për vendimmarrje sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Më pas, kërkuesja iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), me pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit (për mungesë kuorumi), mungesën e paanshmërisë së gjyqtarëve në gjykatën e apelit dhe mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. GJEDNJ konstatoi shkelje të të drejtës së aksesit në Gjykatë, ndërsa nuk i pranoi pretendimet e kërkueses për të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe për cenimin e standardit të arsytimit. Bazuar në vendimin e GJEDNJ-së, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit të përfunduar me vendimin nr. 44/2013 të Gjykatës, duke pretenduar cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, cenimin e standardit të arsytimit të vendimit dhe barazinë e armëve.

Vlerësimi i Gjykatës

Cenimi i të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme – Kërkuesja kishte pretenduar se trupi gjyqësor i Gjykatës së Apelit që kishte disponuar në themel, ishte i njëjtë me atë që ka disponuar më parë për kërkesën për anulimin e veprimeve përmbarimore. Gjykata evidentoi se kërkuesja kishte pranuar se nuk kishte paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve, por i kishte kërkuar trupit gjyqësor të hiqte dorë nga shqyrtimi i çështjes. Në dosjen gjyqësore, nuk rezultoi të ishte një kërkesë e tillë, si dhe se nga procesverbali i seancës datë 5.2.2010 rezultonte se palët ishin dakord me gjykatën dhe se nuk kishin kërkesa paraprake. Gjykata vërejt se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi nuk kishte paraqitur kërkesë për dorëheqjen e anëtarëve të trupit gjyqësor, sipas dispozitave të KPC-së.

Cenimi i standardit të arsytimit të vendimit – Sipas kërkueses vendimi i Gjykatës së Lartë përmban një arsytim de plano, duke përmendur vetëm dispozitën ligjore. Gjykata vëren se në vendimin e Gjykatës së Lartë është pasqyruar vendimmarrja e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, si dhe ligji i zbatueshëm, ndërsa në pjesën arsyetuese Gjykata e Lartë, pasi ka konstatuar se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato që kërkohen në ligj, ka vendosur mospranimin e tij. Në tërësinë e tij vendimi paraqitet i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Gjykata çmon se arsytimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

Cenimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoriteti - Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar përpara gjykatës së Tiranës thirrjen e personave të tretë dhe të një eksperti, kërkesa që nuk janë pranuar nga gjykatat, duke e konsideruar këtë si shkelje të parimit të barazisë së armëve. Në këtë aspekt, Gjykata konstaton se kërkesat paraprake të kërkueses për thirrjen e palëve të treta në gjykim ose ekspertit janë marrë në shqyrtim nga gjykatat, duke iu dhënë pengjigje të argumentuar. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të faktit rezultoi se kërkueses i është dhënë mundësia të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të saj, si dhe të kundërshtojë prapësimet e palës tjetër. Gjithashtu, gjykatat kanë analizuar faktet dhe provat e paraqitura në gjykim përkundrejt atyre të paraqitura nga subjekti i interesuar. Në këtë kuptim, kërkuesja nuk rezultoi të jetë vënë në kushte të pabarabarta me palët e tjera në proces.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta për proces të rregullt— Standardi i arsytimit të vendimit— E drejta e aksesit për vendim gjyqësor

FJALË KYÇE

Rimbursim i shumave doganore të derdhura tepër/ mosparaqitje në gjykim/ pushim gjyqësor/ ligji i ri procedural ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim/interesi i palës paditëse/ mungesi interesit/

Gjykata vlerëson të theksojë, së pari, se ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum* dhe në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri procedural ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe.

Përmbajtja e nenit 179 të KPC (pushimi i gjykimit për mosparaqitje në gjykim) është e lidhur, në thelb, me mungesën e interesit të palës paditëse për zhvillimin e gjykimit.

Edhe pse arsytimi i gjykatës së faktit, nga pikëpamja formale, duket i rregullt, në thelbin e tij ky arsytim nuk ka analizuar faktet e konstatuara në gjykimin kushtetues me qëllim që të arrijë në përfundimin për mungesën e interesit të kërkuësës për vazhdimin e gjykimit.

Shoqëria “A&A International” sh.p.k. (cënimi i të drejtës së aksesit si pasojë e pushimit të gjykimit për shkak të mosparaqitjes në gjykim) - Vendimi nr. 68, datë 08.10.2024

Faktet

Kërkuësja është person juridik që ushtron veprimtarinë në fushën e transporteve dhe specicionit. Nëpërmjet deklaratave doganore, ajo ka kryer procedura doganore pranë Degës së Doganës Kapshticë, duke kaluar mallra nëpërmjet kësaj pike. Duke pretenduar se shuma e paguar është më e lartë se detyrimi i saj, kërkuësja i është drejtuar Degës së Doganës Kapshticë për rishikimin e deklaratave doganore dhe rimbursimin e shumës së derdhur tepër, kërkesë që është rrëzuar. Kërkuësja iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për rimbursimin e shumave doganore. Gjatë gjykimit, gjykata e Korçës vendosi të thërrasë, në cilësinë e personit të tretë, shoqërinë “Huaëei Technologies Albania” sh.p.k., duke çmuar se kishte interes në gjykim, pasi mallrat e zhdoganuara i përkisnin kësaj shoqërie, ndërkohë që paditësja (kërkuësja) vepronte në cilësinë e agentit doganor. Në seancën gjyqësore datë 20.05.2013, gjykata ka konstatuar se asnjë nga përfaqësuesit e paditësës (kërkuësës) nuk është paraqitur në gjykim edhe pse kishin dijeni rregullisht dhe se nuk është paraqitur ndonjë shkak i ligjshëm për mosparaqitjen e tyre. Gjykata e Korçës, bazuar në nenin 179, paragrafi i parë, të KPC-së, vendosi pushimin e gjykimit, vendim që u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Kundër këtij vendimi kërkuësja paraqiti rekurs dhe Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit. Kërkuësja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*).

Vlerësimi i Gjykatës

Për cënimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit - Sipas kërkuësës, gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë mënyrën e zbatimit të ligjit procedural, sjelljen e palëve dhe vetë jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, që ka bërë dallimin mes zbatimit të legjislacionit material dhe atij procedural, që është ai i momentit në të cilin zgjidhet mosmarrëveshja dhe zbatohet menjëherë, përveçse kur vetë ligji parashikon ndryshe.

Gjykata vlerëson të theksojë, së pari, se ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum* dhe në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe. Gjykata vëren se kërkesëpadija është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë në datën 16.02.2012 dhe vendimi i asaj gjykate është dhënë në datën 20.05.2013, për rrjedhojë gjykimi është zhvilluar mbi bazën e dispozitave procedurale në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes.

Gjykata vëren se sipas nenit 179, para. i parë, të KPC-së, mosparaqitja e palës paditëse pa shkaqe të arsyeshme përbënte shkak për pushimin e gjykimit. Megjithatë, përmbajtja e këtyre dispozitave është e lidhur, në thelb, me interesin e palës paditëse për zhvillimin e gjykimit, si dhe me të drejtën e aksesit në gjykim, si e drejtë që i jep mundësi palës të mbrojë të drejtat e interesat e saj të ligjshëm përpara gjykatës, si dhe të ushtrojë në gjykim edhe të drejtat e tjera që i garantohen në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Gjykata vëren se ndërsa kërkuësja (paditësja) dhe e paditura në gjykim kishin bërë pjesë të shqyrtimit gjyqësor pretendimet e tyre, duke u dëgjuar nga gjykata në lidhje me kërkimet dhe prapësimet për to, qëllimi i shtyrjes së seancave gjyqësore ishte që gjykata e Korçës të dëgjonte personin e tretë, pasi kishte vlerësuar se kishte interes për çështjen. Në këtë fazë të gjykimit, kjo gjykatë duhej të shtynte formalisht gjykimin, për sa kohë që jo vetëm që kërkuësja nuk rezulton të ketë qenë shkak për shtyrjen e seancave të fundit gjyqësore, jo vetëm se personi i tretë i thirrur nuk ishte i pranishëm, ndaj nuk mund të paraqiste qëndrimin dhe mendimin e tij për vijimin e gjykimit, por edhe se pala e paditur kishte paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore. Në kushtet kur veçanërisht vendimi i pushimit të gjykimit sjell pasojë në drejtim të aksesit të individit në gjykim, jo vetëm në drejtim të marrjes së një përgjigjeje përfundimtare për kërkimet e ngritura në padi, por, gjithashtu, edhe sepse ndikon në afatin e parashkrimit për ngritjen sërish të padisë. Për rrjedhojë, edhe pse arsytimi i Gjykatës së Korçës, nga pikëpamja formale, duket i rregullt, në thelbin e tij ky arsytim nuk ka analizuar faktet e mësipërme të konstatuara në gjykimin kushtetues me qëllim të arritjes në përfundimin për mungesën e interesit të paditësës (kërkuësës) për vazhdimin e gjykimit, duke sjellë, për pasojë, cënimin e së drejtës së saj të aksesit në drejtim të së drejtës për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në kërkesëpadi.

Vendimarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

E drejta e pronës

FJALË KYÇE

Kontratë shirblerjeje/ pagesa e masës së shpërblimit/ statusi i qytetarit të pastrehë/ vendimi 12/2000 i Gjykatës nuk mohon të drejtën e shpërblimit/ arsyetim formalist/ organi quasi gjykatë vendim të formës së prerë të KKKP

Bazuar në vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës, që ka shfuqizuar nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit 7698/1993, gjykatat nuk kanë marrë parasysh arsyetimin e këtij vendimi, i cili në asnjë rast nuk mohon të drejtën e shpërblimit personave të tretë, përkundrazi, konsideron si të drejtë kushtetuese sigurimin nga shteti të një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut.

Organet publike dhe gjykatat e zakonshme nuk kanë zbatuar detyrimin e përcaktuar në vendimin e KKKP, i cili nuk është ankimuar dhe, si i tillë, nuk mund të vihej në diskutim (si vendim i një organi quasi gjykatë). Prandaj, në kushtet kur në përfundim të procesit gjyqësor kërkuesit nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre të njohur me vendim të formës së prerë të KKKP, Gjykata çmon se atyre u është cenuar e drejta e pronës.

Tomor Bylykbashi, Satliko Bylykbashi (cënimi i të drejtës së pronës si pasojë e mohimit të të drejtës për shpërblim të personave të tretë) - vendim nr. 69, datë 08.10.2024

Faktet

Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të H.B., i cili në vitin 1958 ka blerë një shtëpi banimi në Korçë. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Korçë (KKKP), me vendimin 604/1994 i njohu dhe i ktheu këtë shtëpi trashëgimtarëve të ish-pronarit B.V. Po sipas këtij vendimi, shteti i detyrohej trashëgimtarëve të H.B. pagesën e masës së shpërblimit, sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit të shtëpisë, të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, bazuar në nenin 10 të ligjit 7698/1993. Me vendimin 12/2000,

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka shfuqizuar pjesërisht nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit 7698/1993, duke arsyetuar, ndër të tjera, se rregulli për masën e shpërblimit për ndërtesat ish-pronë private që janë tjetërsuar nga persona të tretë, duke mos marrë për bazë çmimin e tregut, pra vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari, vjen në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit. Trashëgimtarët e ish-pronarit B.V. nëpërmjet një procesi gjyqësor i detyruan kërkuesit t'i lironin dhe dorëzonte shtëpinë. Më pas, kërkuesit i janë drejtuar gjykatës së Korçës për detyrimin e subjekteve të interesuara t'i paguanin vlerën e plotë dhe reale të banesës sipas vendimit 604/1994 të KKKP-së. Çështja u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë e cila vendosi pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin Degës së Thesarit Korçë, që t'i paguajë trashëgimtarëve të H.B. shumën përkatëse. Gjykata Administrative e Apelit vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të Korçës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se kërkimi i tyre për të përfutur shpërblim të plotë dhe real për banesën që ata kanë pasur në posedim dhe që i është kthyer pronarit të ligjshëm, është i pabazuar në ligj e në prova, pasi nuk janë shpronësuar nga pala e paditur, por prona i është kthyer pronarit të saj. Sipas kësaj gjykate, kërkuesit duhet të trajtohen si qytetarë të pastrehë në bazë të aktin normativ 3/2012 "Për lirin e banesave ish-pronarëve" dhe ligjit 82/2012 "Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar." Me rekurs të kërkuesve, Gjykata e Lartë e la në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës, duke pretenduar, para së gjithash, cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës private.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së pronës private - Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të interpretuar normat ligjore në atë drejtim që të prodhojnë një rezultat të pajtueshëm me Kushtetutën, dhe të garantonin të drejtat kushtetuese të kërkuesve. Konkretisht, duke u bazuar në vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës, që ka shfuqizuar nenin 10, paragrafi i parë, të ligjit 7698/1993, gjykatat nuk kanë marrë parasysh arsyetimin e këtij vendimi, i cili në asnjë rast nuk mohon të drejtën e shpërblimit personave të tretë, përkundrazi, konsideron si të drejtë kushtetuese sigurimin nga shteti të një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut, pra vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari. Po kështu, pavarësisht se gjatë procesit nuk është kundërshtuar fakti se shtëpia objekt gjykimi është blerë nga trashëgimlënësi i kërkuesve me kontratë shitblerjeje, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë me një arsyetim formal dhe pa marrë në konsideratë vendimin e KPPP-së, i kanë konsideruar ata si subjekte të aktit normativ nr. 3/2012 dhe ligjit nr. 82/2012, që do të thotë si persona me statusin e qytetarit të pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, është bazuar në një arsyetim formalist dhe interpretim të ngushtë të së drejtës së pronës, që nuk është në përputhje me qëllimin e nenit 41 të Kushtetutës, duke e bërë mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes haptazi të paarsyeshme.

Gjykata vlerëson se organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë zbatuar detyrimin e përcaktuar në vendimin e KKKP-së, i cili nuk është ankimuar dhe, si i tillë, nuk mund të vihej në diskutim (si vendim i një organi quasi gjykatë). Prandaj, në kushtet kur në përfundim të procesit gjyqësor kërkuesit nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre të njohur me vendim të formës së prerë të KKKP-së, Gjykata çmon se atyre u është cenuar e drejta e pronës.

Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesve dhe për t'u dhënë përgjigje atyre në respektim të standardeve kushtetuese, si dhe duke plotësuar mangësitë dhe riparuar shkeljet e gjykatës së apelit.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta për proces të rregullt ligjor - Parimi i prezumimit të pafajësisë – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Shpërdorim detyre/ leje ndërtimi/ nënshkrim i zbardhjes së lejes së ndërtimit/ përgjegjës i seksionit të urbanistikës/ sekretar i KRRT-së/ qenia në detyrë në kohën kur ka ndodhur fakti penal/ fajësia të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm

Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit ka të bëjë, në thelb, me faktin se gjykatat e zakonshme e kanë deklaruar atë fajtor për veprën penale “shpërdorim detyre”, duke mos përcaktuar në mënyrë të saktë faktet e çështjes.

Gjykatat nuk kanë përcaktuar kohën kur kërkuesi e ka ushtruar detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës, duke mos vlerësuar për këtë aktin përkatës të emërimit të administruar si provë në gjykim, sikundër nuk i kanë dhënë përgjigje as pretendimit të tij se nuk ka qenë në këtë detyrë në kohën kur ka ndodhur fakti penal i atribuar atij.

Nga arsytimi i vendimeve gjyqësore nuk duket që gjykatat të kenë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për t'i mbështetur ato në prova të drejtpërdrejta ose të tërthorta të provuara nga akuzat dhe që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Dritan Nuzi (cenimi i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor për shkak të mos përmbushjes dhe mosrespektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë) - Vendimi nr. 70, datë 15.10.2024.

Faktet

Prokuroria Dibrë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “ndërtimi i paligjshëm” dhe më tej, ka regjistruar emrat e kërkuesit dhe të shtetasit I.K., si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim. Fakti penal lidhet me procedurën administrative të dhënies së lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit të një shtese anësore në një pallat ekzistues në Peshkopi, në favor të shtetasve Sh.K. dhe D.M., leje këto të miratuara në datën 29.09.2006 nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Peshkopi (KRRT). Më pas, kërkuesi dhe I.K. janë akuzuar për këtë veprë penale dhe janë dërguar për gjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibrë ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale në fjalë, dhe e dënoi me burgim dhe me heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike. Përsa i përket të bashkëpandehurit I.K., gjykata e deklaroi atë të pafajshëm. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënie në fuqi të vendimit të gjykatës së Dibrës, për sa i përket kërkuesit, duke bërë zëvendësimin e dënimit nga burgim në atë të punës në interes publik. Për ankimin e prokurorisë, gjykata e apelit vendosi mospranimin e tij. Po kështu, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkuesit, i cili iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi prova e vetme për dënimin e tij është nënshkrimi nga ana e tij i zbardhjes së lejes së ndërtimit më 24.03.2010, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së, ndërkohë që leja e ndërtimit ishte miratuar më 29.09.2006, kohë kur kërkuesi ishte student. Po kështu, ai ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi gjykatat, në të njëjtin proces, kanë deklaruar të pafajshëm të bashkëpandehurin I.K., ndonëse edhe ky, njëlloj si kërkuesi, ka nënshkruar, si kryetar i KRRT-së, zbardhjen e të njëjtës leje ndërtimi.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Nën dritën e fakteve, Gjykata vëren se fakti penal i njoftuar kërkuesit në akuzën kundër tij lidhet me procedurat e ndjekura për shqyrtimin e kërkesave dhe, më tej, me miratimin nga KRRT-ja më 29.09.2006 të lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit në favor të shtetasve Sh.K. dhe D.M., si dhe me ushtrimin nga ai gjatë kësaj procedure të detyrës së përgjegjës të seksionit të urbanistikës së Bashkisë. Megjithatë, gjykatat e zakonshme nuk tregojnë në arsytimin e tyre ndonjë provë konkrete të vlerësuar nga ato në lidhje me faktin e pranuar se shqyrtimi administrativ i kërkesave të shtetasve Sh.K. e D.M. për leje sheshi dhe leje ndërtimi, të miratuara në datën 29.09.2006 nga KRRT-ja, është bërë nga kërkuesi, në cilësinë e përgjegjës të seksionit të urbanistikës, sikundër as për faktin se ndërtimi i shtesës anësore nga ata shtetas është bërë gjatë kohës kur kërkuesi ka ushtruar detyrën në fjalë. Në veçanti, gjykatat nuk kanë arsytuar në drejtim të kohës kur kërkuesi ka ushtruar detyrën e përgjegjës të seksionit të urbanistikës, as për provën e kërkuar prej tij, vendimi nr. 40, datë 18.03.2009 të kryetarit të Bashkisë që e ka emëruar kërkuesin në detyrën në fjalë.

Në kuptim të parimit të prezumimit të pafajësisë, nga arsytimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nuk duket që gjykatat të kenë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për t'i mbështetur ato në prova të drejtpërdrejta ose të tërthorta të provuara nga akuzat dhe që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Arsytimi i gjykatave konsiderohet si haptazi i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues. Gjykata vlerëson se specifikat e çështjes konkrete dhe natyra e pretendimit të kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kërkojnë vlerësim nga gjykatat në drejtim të përcaktimit të fakteve në raport me përgjegjësinë penale të kërkuesit.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën e apelit.

Proces i rregullt ligjor - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Punonjës miniere/ pension i veçantë/ vendim bazuar në pretendimet dhe të dhënat e një personi tjetër/ e metë vendimi/

Shkaqet që janë parashtruar nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj dukshëm kanë të bëjnë me një çështje tjetër, të ndryshme nga ajo e kërkesit. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se kjo është një e metë në vendimin e Gjykatës së Lartë, që vë në dyshim standardin e arsytimit të atij vendimi.

Kjo e metë e konstatuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që cenon në tërësi standardin e arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e ankimit, për sa kohë që nuk i lejon Gjykatës të arrijë në një përfundim të drejtë nëse Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkesi në rekurs.

Prend Suta (cenimi i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor për shkak të mosbazueshmërisë së vendimit në faktet e çështjes) Vendimi nr. 71 datë 15.10.2024

Faktet

Kërkesi i është drejtuar DRSSH-së, Shkodër me kërkesë për lidhjen e pensionit të veçantë si punonjës nëntoke, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë" (ligji nr. 8685/2000). Bazuar në këtë ligj, DRSSH-ja i caktoi kërkesit trajtim të veçantë edhe si punonjës nëntoke. Pasi hyri në fuqi të ligji 150/2014, datë 06.11.2014 "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë" (ligji nr. 150/2014), kërkesi ka paraqitur kërkesë për pension pleqërie të kategorisë së parë sipas parashikimeve të këtij ligji. DRSSH-ja ia refuzoi kërkesën, si dhe vendosi mbylljen e trajtimit të veçantë që kërkesi përfitonte sipas ligjit nr. 8685/2000, si dhe e ngarkoi me një detyrim. Kërkesi u ankua në Komisionin Rajonal të Ankimit, Shkodër, i cili u shpreh se nuk kishte kompetencë për shqyrtimin e kërkesës. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Komisioni Qendror i Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Kërkesi iu drejtua gjykatës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të DRSSH-së dhe të Komisioneve. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër vendosi rrëzimin e padisë, vendim që u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Për rekursin e kërkesit, Gjykatës e Lartë vendosi mospranimin e tij. Kërkesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor - Kërkesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin e saj në pretendimet dhe të dhënat e një personi tjetër dhe, për rrjedhojë, nuk ka shqyrtuar pretendimet e ngritura nga kërkesi në rekurs dhe nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke mos e arsytuar vendimin e saj.

Gjykata, referuar përmbajtjes së rekursit të paraqitur nga kërkesi bashkëlidhur kërkesës, por edhe vetë përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Lartë, konstaton se shkaqet e paraqitura në vendimin e asaj gjykate qartazi nuk kanë lidhje me çështjen e kërkesit dhe as me faktet që kanë rezultuar gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit apo që kërkesi pretendon se janë provuar gjatë atij procesi. Shkaqet që janë parashtruar nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj dukshëm kanë të bëjnë me një çështje tjetër, të ndryshme nga ajo e kërkesit. Për rrjedhojë, në prani të këtij fakti, Gjykata vëren se kjo është një e metë në vendimin e Gjykatës së Lartë, që vë në dyshim standardin e arsytimit të atij vendimi, përderisa në arsytimin e kufizuar të tij, në pjesën hyrëse të vendimit, nuk listohen shkaqet e rekursit të kërkesit, çka vë në dyshim vlerësimin e asaj gjykate gjatë shqyrtimit paraprak të tij dhe përfundimet e arritura nga ajo në lidhje me shkaqet e mospranimin të rekursit, për rrjedhojë edhe ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit të kërkesit në një gjykatë më të lartë. Kjo e metë e konstatuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që cenon në tërësi standardin e arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e ankimit, për sa kohë që nuk i lejon Gjykatës të arrijë në një përfundim të drejtë nëse Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj dhe në zbatim të parimit të subsidiaritetit, i ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkesi në rekurs dhe nëse përfundimi në lidhje me (pa) bazueshmërinë e tyre është rrjedhojë e analizës së këtyre shkaqeve. Për sa u përket pretendimeve të tjera të ngritura nga kërkesi, Gjykata vlerëson se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, është detyrë e Gjykatës së Lartë që t'i vlerësojë dhe t'u japë atyre përgjigje në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë Gjykatë.

E drejta për proces të rregullt - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Rekurs/ Avokaturë e Shtetit/ pathemelësi e rekursit/ abuzim me rekursin/

Vendosja e gjobës për abuzim me rekursin është një masë procedurale që synon të sigurojë administrimin e duhur të drejtësisë dhe ka për qëllim shmangien e abuzimeve me të drejtat në procesin gjyqësor. Nga ana tjetër, gjykatat e zakonshme kanë detyrim të shtuar, që në arsyetimin e vendimit, krahas mënyrës së zgjidhjes së çështjes të tregojnë me qartësi, jo vetëm ligjin e zbatueshëm për caktimin e gjobës, por edhe faktin konkret, në kuptimin se përse një sjellje e caktuar përbën abuzim me të drejtën.

Dashmir Alsula (dënim i avokatit për shtetit për shka të paraqitjes së një rekursi abuziv) – vendimi nr. 72, datë 17.10.2024

Faktet

Kërkuesi ushtron detyrën e avokatit të shtetit, i caktuar në Ministrinë e Brendshme, në zbatim të ligjit për Avokaturën e Shtetit. Në një çështje gjyqësore ku e paditur ishte Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, kërkuesi nënshkroi rekursin me anë të të cilit kundërshtojë vendimi i dhënë kundër të paditurit. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ia dërgoi rekursin Gjykatës Administrative të Apelit, recurs që iu përçoll Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit vendosi mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë shkak të parashikuar në nenin 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative, dhe dënimin e kërkuesit me gjobë në masën 50,000 lekë, në bazë të nenit 34, pika 1 të KPC-së. Kërkuesi paraqiti ankim në Gjykatën e Lartë, e cila vendosi mospranimin e tij. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*).

Vlerësimi i Gjykatës

Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor - Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se ku qëndronte pathemelësia dhe abuziviteti i rekursit, në kushtet kur recursi ishte i rregullt në formë dhe në përmbajtje dhe në mënyrën e të argumentuarit. Gjykata evidentoi se në vendosjen e gjobave të tilla, gjykatat e zakonshme kanë detyrim të shtuar që, krahas mënyrës së zgjidhjes së çështjes të tregojnë me qartësi, jo vetëm ligjin e zbatueshëm për caktimin e gjobës, por edhe faktin konkret, në kuptimin se përse një sjellje e caktuar përbën abuzim me të drejtën. Në çështjen konkrete, Gjykata theksoi se një detyrim i tillë për Gjykatën e Lartë merr rëndësi përcaktuese kur ajo vendos mospranimin e rekursit në bazë të nenit 34, pika 1 të KPC-së. Në këto raste, Gjykata e Lartë vlerëson me diskrecion, mbështetur në aktet e dosjes gjyqësore dhe në interpretimin e ligjit, ndaj vlerësimi i mëtejshëm se paraqitja e rekursit ka qenë në abuzim me të drejtën për arsye të pathemelësisë së shkaqeve nuk mund të arsyetohet në mënyrë standarde, abstrakte dhe të kufizuar, përndryshe, arsyetimi cenon balancën kushtetuese që duhet të ekzistojë midis së drejtës për të paraqitur recurs dhe nevojës për të ruajtur procesin gjyqësor nga rekursit abuzive. Gjykata konstatoi se qëndrimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, sepse ajo u mjaftua vetëm me interpretimin se kur aplikohet neni 34, pika 1, i KPC-së, pa e lidhur zbatimin e tij me rrethanat e rastit, por vetëm me faktin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative. Konkretisht, arsyetimi se kur gjen zbatim neni 34, pika 1, i KPC-së gjendet i pasqyruar në 8 paragrafë, që përmbajnë një shpjegim të detajuar të ligjit të zbatueshëm, të procedurës së caktimit ankimit kundër gjobës, por në to, mungojnë arsytet se përse recursi konkret përbënte abuzim me të drejtën. Në vijim, Gjykata evidentoi, gjithashtu, se të metat kushtetuese të mësipërme nuk u korrigjuan nga Gjykata e Lartë në dhënien e vendimit që rrëzoi ankimin për revokimin e dënimin të gjobës.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj — E drejta e aksesit për gjykim — E drejta e standardit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Kontratë koncesionare/ zgjidhje mosmarrëveshjeje me arbitrazh/ përjashtim juridiksioni gjyqësor/ ankim ose rekurs i veçantë/ përbërje e trupit gjykues/ vullneti i palëve i shprehur në kontratë

Me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 49/2012, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, përveç (i) rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar paditë ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe (ii) gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.” Duke qenë se Gjykata e Lartë nuk gjendej përpara asnjërit prej këtyre rasteve, shqyrtimi i çështjes nga një trup gjykues prej 3 anëtarësh nuk bie ndesh me parashikimet ligjore.

Fakti që kërkueset kanë pasur më shumë se 8 muaj në dispozicion për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes në gjykatën e Tiranës, si dhe fakti që kërkueset, duke ushtruar ankim të veçantë ndaj vendimit të gjykatës, kanë pasur mundësinë dhe kanë parashtruar në Gjykatën e Lartë pretendimet e tyre për çështjen e juridiksionit, e rrëzon pretendimin e tyre për mungesë aksesit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.

Juridiksioni lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve, me arbitrazh ose me rrugë gjyqësore, varet dhe përcaktohet nga dhe me vullnetin e vetë palëve, të materializuar në kontratën e koncesionit.

Shoqëria “ANK” sh.p.k., Shoqëria “Bardh Konstruksion” sh.p.k. (cenimi i të drejtës së për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak se përbërja e trupit gjykues nuk ishte formuar sipas ligjit; cënimi i të drejtës së aksesit për gjykim për shkak se gjykatat nuk kanë shqyrtuar pretendimet në themel) - Vendimi nr. 73 datë 17.10.2024

Faktet

Kërkueset dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (autoriteti kontraktor) nënshkruan një kontratë koncesionare. Ndër të tjera, pika 3 e neni 54 të kontratës përcaktonte zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve me arbitrazh ndërkombëtar. Sipas kontratës, kërkueset paguan primin për sigurimin e kontratës tek një shoqëri sigurimi. Në një moment, autoriteti i kërkoi shoqërisë së sigurimit t'i transferonte vlerën e sigurimit të kontratës nga shoqëria e sigurimit tek autoriteti për llogari të kërkueseve, gjë që shoqëria e sigurimit nuk e bëri. Për pasojë, autoriteti e paditi shoqërinë e sigurimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Kërkueset, pasi u vënë në dijeni të këtij fakti, iu drejtuan me padi të njëjtës gjykatë kundër autoritetit me objekt detyrimin e këtij të fundit të vazhdonte procedurat e kontratës së koncesionit. Gjykata e Tiranës vendosi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi referuar kontratës, palët kishin rënë dakord të zgjidhnin mosmarrëveshjet me arbitrazh, duke përjashtuar juridiksionin gjyqësor. Me ankim të veçantë, kërkueset iu drejtuan Gjykatës së Lartë, e cila e la në fuqi vendimin. Kërkueset iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata vëren se kërkueset pretendojnë, së pari, se gjykata e Tiranës duhej ta kishte gjykuar çështjen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, dhe Gjykata e Lartë duhej ta kishte gjykuar me 5 gjyqtarë. Në këtë aspekt, Gjykata konstaton se pretendimi lidhur me përbërjen e trupit gjykues në gjykatën e Tiranës nuk është ngritur nga kërkueset në rekursin e veçantë të paraqitur në Gjykatën e Lartë, por është artikulluar për herë të parë në ankimin kushtetues. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkueset nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive që kanë pasur në dispozicion për këtë pretendim. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes nga një trup gjykues prej 3 anëtarësh nuk bie ndesh me parashikimet ligjore. Në këto kushte, pretendimi i kërkueseve për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

Në lidhje me cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur - Kërkueset kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pasi gjykatat nuk kanë shqyrtuar themelin e pretendimeve. Kontrata koncesionare duke përdorur fjalën “mund” ka përcaktuar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me arbitrazh si alternativë ndaj zgjidhjes gjyqësore, por që në asnjë rast nuk e përjashton këtë të fundit. Ndërkohë që në padinë e tyre, kërkueset kanë kërkuar vijimin e procedurave të zbatimit të kontratës koncesionare. Gjithashtu, gjykata e Tiranës nuk i ka dhënë mundësinë për t'u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me kërkesën e autoritetit për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Gjykata konstaton se nga përmbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore në gjykatën e Tiranës nuk rezulton që kërkueset t'i kenë dhënë prapësimet e tyre me gojë ose me shkrim në seancë, ose t'i kenë kërkuar gjykatës të administrojë pretendimet e tyre me shkrim. Po kështu, Gjykata vëren se nga data kur autoriteti kontraktor ka paraqitur kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, deri në momentin që ajo është marrë në shqyrtim, kërkueset kanë pasur më shumë se 8 muaj në dispozicion për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkueset, duke ushtruar ankim të veçantë, kanë pasur mundësinë dhe kanë parashtruar në Gjykatën e Lartë pretendimet e tyre për çështjen e juridiksionit. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, ka analizuar pretendimet e kërkueseve. Sipas Gjykatës së Lartë, juridiksioni lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve, në rastin konkret, i takon arbitrazhit të Parisit, sipas vullnetit të vetë palëve, të materializuar në kontratën e koncesionit. Ajo ka arsytuar se pavarësisht përdorimit të fjalës “mund” në nenin 54, pika 3, të kontratës, në tërësi, shkallëzimi i mekanizmave zgjidhës (negociatat dhe eksperti teknik), renditja e tyre kronologjike dhe semantika e dispozitave në pikat 2 dhe 3 të nenit 54 të kontratës, reflektojnë vullnetin e palëve që zgjidhjen e mosmarrëveshjeve t'ia nënshtrojnë ekskluzivisht arbitrazhit ndërkombëtar, duke përjashtuar në mënyrë implicite juridiksionin gjyqësor shqiptar.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës. (Dy gjyqtarë janë shprehur me vendim pakice kundër)

Procesi i rregullt ligjor – Parimi i sigurisë juridike – E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Faturë tatimore elektronike shitjeje/ urdhër ekzekutimi – titull ekzekutiv/ masa e pezullimit të urdhërit ekzekutiv/ masa e sigurimit të padisë/

Ligji procedural civil dallon masat e përkohshme për sigurimin e padisë që mund të vendosen në një gjykim të zakonshëm, nga ato që mund të vendosen në një gjykim që lidhet me ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Në rastin konkret gjykata e apelit kërkesën e debitorit e ka konsideruar si kërkesë për sigurimin e padisë, por në përfundim ajo nuk ka vendosur për marrjen e ndonjë mase sigurimi padie, por për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Shoqëria “Tirana Auto” sh.p.k. (cenimi i parimit të procesit të rregullt ligjor lidhur me arsytimin e vendimit për shkak se gjykatat nuk mbajnë parasysh kushtet e ligjit) - Vendim nr. 74 datë 22.10.2024

Faktet

Kërkuesja dhe subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH), kanë lidhur një kontratë për marrje mjetesh me qira. Pas përfundimit të kontratës, kërkuesja ka lëshuar dy fatura tatimore elektronike shitjeje të cilat nuk u shlyen nga DPPSH-ja. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila vendosi lëshimin e urdhrat të ekzekutimit për titujt ekzekutivë, për faturat tatimore. Përmbaruesi që u angazhua njoftoi debitorin, DPPSH-në, për të ekzekutuar detyrimin vullnetarisht. DPPSH-ja e kundërshtoi përmes tre proceseve gjyqësore. Në procesin e parë, DPPSH kundërshtoi me padi veprimin përmbarimor, si dhe kërkoi edhe marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit, masë e cila u refuzua nga gjykata e Tiranës. Më pas, gjykata e Tiranës e refuzoi edhe padinë me arsytimin se DPPSH nuk legjitimohej. Gjykata Administrative e Apelit e prishi vendimin e gjykatës së Tiranës dhe e ktheu çështjen në po atë gjykatë. Në procesin e dytë, DPPSH-ja kundërshtoi veprimin përmbarimor për shkak të përllogaritjes së kamatë-vonesave nga përmbaruesi, si dhe kërkoi sërish pezullimin e ekzekutimit, pezullim që u rrëzua sërish nga gjykata e Tiranës. Në procesin e tretë gjyqësor, DPPSH-ja iu drejtua gjykatës së apelit me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbarimor, e cila u pranua nga kjo gjykatë. Rekursi i kërkueses nuk u pranua nga Gjykata e Lartë. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Cënimi i parimit të sigurisë juridike. Gjykata thekson, se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike lidhet me faktin se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm edhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.

Për cenimin e arsytimit të vendimit - Kërkuesja ka pretenduar, në thelb, se gjykatat nuk kanë saktësuar nëse çështja ka të bëjë me sigurimin e padisë në gjykimin administrativ, bazuar tek nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, lidhur me nenet 202 e vijues të KPC-së, apo me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, që rregullohen nga nenet 609 dhe 610 të KPC-së.

Gjykata konstaton se ligji procedural civil dallon masat e përkohshme për sigurimin e padisë që mund të vendosen në një gjykim të zakonshëm, nga ato që mund të vendosen në një gjykim që lidhet me ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Gjykata vëren se në rastin konkret gjykata e apelit kërkesën e DPPSH e ka konsideruar si kërkesë për sigurim padie, por në përfundim ajo nuk ka vendosur për marrjen e ndonjë mase sigurimi padie, por për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Po kështu, Gjykata konstaton se edhe Gjykata e Lartë e ka mbështetur këtë arsytim.

Në rastin konkret Gjykata vëren se gjykata e apelit, për sa u përket arsyeve për vendosjen e masës së pezullimit të ekzekutimit, u është referuar kushteve për sigurimin e padisë. Në këtë mënyrë është e dukshme se gjykata, pavarësisht mjetit që e ka vënë në lëvizje, nuk u është referuar kushteve të parashikuara nga ligji për atë mjet, por një mjeti tjetër, mjete këto që në fakt përfaqësojnë dy institute të ndryshme të së drejtës procedurale civile, të cilat, pavarësisht ngjashmërive si masa me karakter të përkohshëm, dallojnë për nga përmbajtja dhe natyra e tyre juridike. Në këtë kuptim, duke qenë se pretendimet e kërkueses të parashtruara në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ishin sa me natyrë ligjore po aq edhe kushtetuese, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit dhe duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare atyre pretendimeve nuk ka përmbushur detyrimin e saj si gjykatë ligji.

Kërkuesja ka kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit, por kjo kërkesë u rrëzua pasi Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës; shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë; dërgimin e çështjes për shqyrtim po në Gjykatën e Lartë; rrëzimin e kërkesës për kërkimin e dytë në lidhje me shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit (katër gjyqtarë votuan kundër kërkimit të dytë).

E drejta e aksesit për gjykim – Standardi i vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Disponim me testament/ pavlefshmëri testamenti/ rezerva ligjore – për paaftësi për punë/ pavlefshmëri testaminti – për disponim jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë/ gjë e gjykuar

Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përveç rasteve kur gjetjet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e zakonshme është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë.

Avenir Ballvora (cënimi i të drejtë së aksesit gjyqësor në lidhje me standardin e vendimit për shkak të interpretimit të gabuar të parimit të gjësë së gjykuar) - Vendimi nr. 75, datë 28.10.2024

Faktet

Trashëgimtarët Haxhire Ballvora, Sulltane Merja (Ballvora), Fatmira Ballvora dhe vëllai (i ati i kërkuesit) i tyre fituan një shtëpi me trashëgimi ligjore nga babai i tyre. Motrat dhe i vëllai ia kaluan pjesët e tyre Haxhire Ballvorës me kontrata të rregullta më 1987. Në vitin 1992, Haxhire Ballvora ia dhuroi shtëpinë shtetasit Hajdar Qufaj, i cili, në vitin 1996, ia dhuroi atë Vasil Nishku. Ky i fundit në 1998 ia dhuroi shtëpinë kërkuesit. E drejta e pronësisë mbi këtë shtëpi është bërë objekt gjykimi në pesë procese gjyqësore. Në përfundim të tre proceseve të para, kontratat e dhurimit u deklaruan të pavlefshme dhe shtëpia iu rikthye Haxhire Ballvorës, e cila në vitin 2000, ia kaloi atë subjektit të interesuar, Shaqir Shtishi, me testament.

Procesi i katërt gjyqësor (2005) lidhej me padinë e Sulltane Merja (Ballvora), me objekt kundërshtimin e testamentit të Haxhire Ballvorës, duke pretenduar se i ishte cenuar rezerva e saj ligjore, për shkak se ishte e paaftë për punë. Gjykata e Tiranës e rrëzoi padinë me arsyetimin se rezerva ligjore nuk ishte prekur, pasi paditësja nuk kishte jetuar me testatoren të paktën një vit përpara vdekjes së saj, vendim i cili mbeti në fuqi në përfundim të gjykimit në të gjitha shkallët.

Procesi i pestë gjyqësor (2013) lidhej me padinë e kërkuesit për konstatimin e pavlefshmërisë së testamentit të Haxhire Ballvora, duke pretenduar, në thelb, se subjekti i interesuar nuk përfshihej në rrethin e trashëgimtarëve dhe nuk mund të përfitonte me testament. Gjykata e Tiranës e rrëzoi padinë. Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin, duke konstatuar pavlefshmërinë e testamentit të Haxhire Ballvorës, si dhe e pushoi gjykimin, me arsyetimin se subjekti i interesuar ishte jashtë radhëve të trashëgimisë ligjore të Haxhire Ballvorës, për pasojë nuk mund të trashëgonte këtë. Gjithashtu, motra e saj, Fatmira Ballvora, ishte e gjallë në kohën e hartimit të testamentit, fakt që e ndalonte Haxhiren të dispononte jashtë radhëve të trashëgimtarëve ligjorë. Gjykata e Lartë, në përfundim, vendosi prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pushimin e gjykimit, me arsyetimin se gjykatat e faktit nuk kishin interpretuar drejt parimin e gjësë së gjykuar. Kërkuesi i drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

Për cënimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor - Duke u ndalur tek të dhënat e dy proceseve gjyqësore të fundit, që janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë si gjë e gjykuar, Gjykata vë në dukje se procesi gjyqësor, i përfunduar më herët nga gjykatat e zakonshme është vënë në lëvizje nga Sulltane Merja (Ballvora), me objekt "pavlefshmërinë e testamentit të testatores Haxhire Ballvora", bazuar në nenet 360 e vijues të KC-së, me shkak ligjor cënimin e rezervës ligjore të Sulltane Merja (Ballvora), si e paaftë për punë dhe në ngarkim të trashëgimlënësës. Ky proces gjyqësor ka përfunduar (në të gjitha shkallët) me rrëzimin e padisë, me arsyetimin se rezerva ligjore nuk rezultonte të ishte prekur. Ndërkohë, procesi tjetër gjyqësor, objekt i ankimit kushtetues, është vënë në lëvizje nga kërkuesi, kundër subjektit të interesuar, me objekt "pavlefshmërinë e testamentit të testatores Haxhire Ballvora", bazuar në nenet 374, 377 dhe 379 të KC-së, duke pretenduar, ndër të tjera, se subjekti i interesuar nuk përfshihet në rrethin e trashëgimtarëve të testatores Haxhire Ballvora.

Në këto rrethana, Gjykata vëren se bëhet fjalë për dy procese gjyqësore, të cilat ndonëse kanë objekt dhe bazë ligjore të njëjtë, pavlefshmërinë e testamentit, ndryshojnë në lidhje me shkaqet ligjore të padive të ngritura. Analiza e Gjykatës së Lartë për këto rrethana përmban gabim faktik të dukshëm në përcaktimin se dy proceset gjyqësore kanë pasur shkaqe ligjore të njëjta, që kanë sjellë si rezultat edhe gabimin ligjor në interpretimin e gjësë së gjykuar. Kjo do të thotë se analiza e Gjykatës së Lartë përmban gabime faktike, të cilat nuk janë objektivist të justifikueshme dhe të arsyeshme, çka ka sjellë edhe interpretimin e gabuar të ligjit në funksion të (mos)zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi njëzëri pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta për proces të rregullt – E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor – E drejta e pronës

FJALË KYÇE

Njohje pronësie/ pronë e njohur dhe kthyer më parë/ kundërshtim brenda afatit/ ndjekja e rrugës administrative/ mosaplikim i afatit 30 ditor të ankimit administrativ.

Sipas Ligjit 9235/2004, subjektet e shpronësuara nuk kanë detyrim për t'iu drejtuar rrugës administrative nëse për të njëjtën pronë, ish-KKKP-ja ose AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen dhe kthimin e saj një subjekti tjetër të shpronësuar, raste në të cilat çështja i përket juridiksionit gjyqësor.

Për sa i përket të drejtës së ankimit në gjykatë kundër vendimeve të AKKP-së, ligji 9235/2004 ndërsa ka parashikuar një të drejtë të tillë për subjektet e shpronësuara, nuk ka përcaktuar afate për ushtrimin e saj. Afati prej 30 ditësh u parashikua më vonë, me ndryshimet e bëra ligjit nr. 9235/2004 me ligjin nr. 10207/2009. Por këto ndryshime, duke mos pasur karakter retroaktiv, nuk zbatohen për rastin konkret që ka ndodhur më parë në kohë.

Fatma Hoxha, Arlind Hoxha, Endri Hoxha (cenimin i së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor për shkak se kërkuesit nuk u legjitimuan për ngritjen e padisë) - Vendim nr. 76, datë 29.10.2024

Faktet

Në vitin 1955, Gjykata Popullore e Rrethit Durrës ka vërtetuar faktin juridik të pronësisë në favor të shtetasit A.H. (trashëgimlënësi i kërkuesve) për një truall me sipërfaqe 1310 m² dhe të dy ndërtesave të ngritura mbi të. Ky akt u regjistrua dhe trashëgimtarët e A.H. i ndanë dhe i pjesëtuan këto pasuri vullnetarisht ndërmjet tyre. Në vitin 2006 trashëgimtarët e A.H. i janë drejtuar ZRKKP-së, Durrës për njohjen e pronësisë për një pjesë të truallit, sipas ligjit nr. 9235/2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.. ZRKKP-ja vendosi mosshqyrtimin e kërkesës për shkak se prona i ishte njohur dhe kthyer më parë Komunitetit Mysliman me vendimin nr. 205/1, datë 06.06.1997 të KKKP-së. Mbi ankimin e kërkuesve, me vendimin 240/2007, AKKP-ja vendosi mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për trashëgimtarët e A.H. mbi truallin. Në vitin 2012 kërkuesit iu drejtuan gjykatës, duke kërkuar anulimin e vendimit të KKKP-së në favor të Komunitetit Mysliman, si dhe regjistrimin e truallit në emër të tyre. Gjykata e Durrësit vendosi rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se paditësi nuk legjitimohej për kundërshtimin e vendimit të KKKP-së Durrës, pasi ai nuk kishte kundërshtuar brenda afatit ligjor vendimin nr. 240/2007 të AKKP-së. Gjykata e Apelit e la në fuqi vendimin e gjykatës së Durrësit. Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Pavarësisht natyrës dhe llojit të padisë së kërkuesve, Gjykata e Durrësit e ka rrëzuar atë, me argumente si të natyrës procedurale, ashtu dhe substanciale. Ndërsa, gjykata e apelit e la në fuqi vendimin e Gjykatës së Durrësit, duke konsideruar vetëm argumentet e natyrës procedurale, që u mbështetën si të ligjshme nga Gjykata e Lartë.

Gjykata vëren se për sa i përket ligjit nr. 9235/2004, Gjykata e Lartë ka bërë interpretimin unifikues të tij, duke arritur në përfundimin se në zbatim të këtij ligji, subjektet e shpronësuara nuk kanë detyrim për t'iu drejtuar rrugës administrative nëse për të njëjtën pronë, ish-KKKP-ja ose AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen dhe kthimin e saj një subjekti tjetër të shpronësuar, raste në të cilat çështja i përket juridiksionit gjyqësor.

Për sa i përket të drejtës së ankimit ndaj vendimeve të AKKP-së në gjykatë, Gjykata vëren se në momentin kur AKKP-ja ka disponuar me vendimin nr. 240/2007 për mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për trashëgimlënësin e kërkuesve, ligji nr. 9235/2004, ndonëse parashikonte të drejtën e ankimit për subjektet e shpronësuara, nuk përcaktonte afate për ushtrimin e saj. Afati prej 30 ditësh u parashikua më vonë, në nenin 18 të tij, vetëm pas ndryshimeve të bëra atij me ligjin nr. 10207/2009; kjo dispozitë duket se është zbatuar në rastin konkret nga gjykatat e zakonshme.

Gjykata konstaton se mosmarrëveshja e parashtruar përpara gjykatave lidhet me të drejtën e pronësisë, ndërsa padia e kërkuesve për njohjen e kësaj të drejte është rrëzuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë me argumente të natyrës procedurale, pa e shqyrtuar atë në themel. Në situatën konkrete, kërkuesit as kanë pasur detyrimin për të ndjekur rrugën administrative për njohjen dhe kthimin e pronës, sikundër as vendimi i AKKP-së nuk mund çonte në humbjen e së drejtës së tyre të pronësisë dhe as të kushtëzonte ushtrimin nga ata të së drejtës së padisë për kërkimin e pronës. Gjykata vlerëson se gjetjet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë nuk përmbushin funksionin e një vendimi të drejtë nga pikëpamja e arsytimit. Po kështu, duke mos e shqyrtuar padinë e kërkuesve në themel, gjykatat u kanë cenuar kërkuesve të drejtën e aksesit në gjykatë.

Vendimmarrja

Gjykata Kushtetuese vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

